



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROCESVERBAL

Procesverbal i mbajtjes së debatit publik për shqyrtimin e Projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit me datë 03.09.2020 ora 14:00, sala e Kuvendit Komunal.

Të pranishëm nga zyrtarët komunalë janë:

1. Vlora Krasniqi, Kryesuese e Komisionit
2. Rafete Retkoceri, Zyrtare në DSHP
3. Islam Kaleshi, anëtar i komisionit
4. Salihe Marevci, anëtare e komisionit

Debatin publik e hapi Vlora Krasniqi, Kryesuese e Komisionit për hartimin e Projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave komunale e cila prezentoj draftin e Projekt-Rregullores e cila është në fazën e konsultimit me publikun dhe pritët të miratohet në seancën e Kuvendit të Komunës të muajit shtator dhe kërkoi nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafiti pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete për çështje që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Lipjanit.

Argjend Reqica nga fshati Rubovc kërkoi sqarime nga Komisioni se a janë shpërndarë kontenjerët për mbeturina në gjithë territorin e Komunës së Lipjanit dhe a ka përfunduar shpërndarja apo është në proces.

Rafete Retkoceri, Zyrtare në Drejtoratin për Shërbime Publike i sqaroi të pranishmit se Komuna është në proces të shpërndarjes së kontenjerëve dhe shumica e fshtarave dhe lagjeve të qytetit të Lipjanit janë paisur si dhe ka pasur kërkesa për ndërrim të kontenjerëve përshkak të demolimit ose shkatërrimit dhe të njëjtit janë ndërruar nga Komuna.

Vlora Krasniqi, Kryesuese e Komisionit i njoftoj të pranishmit se pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të Rregullores qytetarët do të obligohen gjatë kryerjes së shërbimeve komunale të sjellin një faturë si dëshmi se kanë kryer obligimet ndaj Kompanisë së kontraktuar nga Komuna.

Shefki Rudari nga fshati Rubovc kërkoi që të shtrohet një pjesë e rrugës të lagjes së tyre e cila ka shumë baltë dhe është në gjendje të keqe pasi kamionët nuk do të kenë mundësi ti bartin mbeturinat nga kjo pjesë e fshatit.

Qytetarët e pranishëm shtruan edhe pyetje dhe propozime që ndërlidhen me fushën e infrastrukturës në përgjithësi .

Qytetarët e pranishëm nuk paten ndonjë vërejtje apo kërkesë për ndryshim ose plotësim të ndonjë neni konkret të Projekt-Rregullores dhe u mbyll takimi.

Vlora Krasniqi
Kryesuese e Komisionit

